

VENDIM
Nr. 778, datë 7.11.2012

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË PËRGJITHSHME, MINIMALE, TË PERSONELIT NJTIK PËR STRUKTURIMIN ORGANIZATIV TË NJËSIVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT E TË KOMUNIKIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të përgjithshme, minimale, të personelit NJTIK për strukturimin organizativ të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit, sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen për institucionet e administratës publike, në nivel qendror, ku përfshihen aparatet e Kryeministrit, të ministrive, degët e ministrive, institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe ministrive të linjës dhe degët e tyre, si dhe administrata e prefektit.

Rekomandohen drejtuesit e institucioneve qendrore të pavarura, përfshi ato të sistemit gjyqësor e të prokurorisë, e institucioneve të arsimit të lartë dhe të fondeve speciale, të zbatojnë të njëjtat standarde gjatë hartimit të strukturave të teknologjisë së informacionit e të komunikimit për administratat e institucioneve të tyre.

3. Ngarkohen ministri që mbulon departamentin e administratës publike, në bashkërendim me Ministrin e Financave dhe Ministrin për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, të përgatitin, për propozim, strukturën, masën e pagës dhe të shtesave mbi pagë të nëpunësve të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit.

4. Ngarkohen ministri që mbulon departamentin e administratës publike dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për kriteret e veçanta të nevojshme për hartimin e strukturave të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit dhe për mënyrën e bashkëpunimit e të bashkërendimit të punës në këto njësi.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Financave dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha